



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 268 Prot.

Tiranë, më datë 14.06.2019

**VENDIM**

**Nr.226, datë 14.06.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 14.06.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit: "Ndërtimi i hidrocentralit "Grabovë 2" mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në Qarkun Elbasan.  
- *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Ura Mesjetare e Gurit” në fshatin Grabovë e Sipërme, Lenie, Bashkia Gramsh;*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 144-147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

